

KËRKESË
Nr. 67, datë 11.1.2020

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “POP
LOL”**

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitetet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: objekt i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja Dega Rajonale Qarku Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2019 004146-5, datë 10.11.2019 për subjektin “POP LOL”, me adresë: Njësia Administrative nr. 5, rruga “P. Bogani”, Vila nr. 32, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2019-004146-5

Datë 10.11.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2019-004146-2, datë 10.11.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “POP LOL”, NIPT: L82226008Q, përfaqësues i autorizuar i subjektit: refuzon inspektimin, prej datës 10.11.2019 deri në datën 10.11.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 10.11.2019 dhe e njoftoi në datën 10.11.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pika “b”.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit, neni 54, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 100 000 lekë

Gjobë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Johana Sinani ID 0401070008

Daniela Spahiu ID 0401030004

Enea Bufi ID

Personi i autorizuar i subjektit
Refuzon inspektimin

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "POP LOL" ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.